

Ftohësi me ngrirësin

Ju falënderohemi për mirëbesimin tuaj që keni treguar me rastin e blerjes së aparatit tonë.
Ju dëshirojmë kënaqësi tek përdorimi.

Ftohësi me ngrirësin i është dedikuar përdorimit në amvisëri.

Pjesa e poshtme është frigorifer, i dedikur ruajtjes së artikujve ushqimor të freskët në temperatura më të larta se 0°C.

Pjesa e sipërme është ngrirës, i dedikuar për ngrirjen e artikujve ushqimor të freskët dhe ruajtjes afatgjate të artikujve ushqimor të ngrirë (deri në një vit, varësisht nga lloji i artikullit). Hapësira është e shënuar me katër yje.

Vërejtje të rëndësishme	106
Këshilla për kursimin e energjisë elektrike te aparatet për ftohje dhe ngrirje.....	107
Përshkrimi i aparatit	108
Vendosja dhe aderimi.....	109
Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës.....	110
Komandimi i aparatit	112
Rradhitja e rekomanduar e artikujve ushqimor në aparat	114
Ruajtja e artikujve ushqimor në frigorifer	115
Ngrirja dhe ruajtja e artikujve ushqimor të freskët	116
Shkrirja e aparatit	118
Pastrimi i aparatit	119
Evitimi i pengesave	120
Informatat për zhurmën e aparatit	121

- Aparati është i prodhuar në ujdi me standardet mbrojtëse të parapara me rregulla, megjithate, nuk ju rekomandojmë që pa mbikqyrje të nevojshme t'a përdorin personat me kapacitete të dobësuara fizike, lëvizëse ose mentale, resp. personat me mangësinë e përvojës ose të diturisë.
- Para kycjes së aparatit, nevojitet që me saktësi të lexoni udhëzimet për përdorim, të cilat përshkruajnë aparatit dhe përdorim e tij të rregullt dhe të sigurtë. Ata janë të adaptuara tipeve/ modeleve të ndryshme të aparateve, prandaj, është e mundëshme që të jenë të përshkruara edhe rregullimet dhe pajimet të cilat nuk i përban aparatit i juaj.
- Evitoheni ambalazhin e dedikuar për mbrojtjen e aparatit resp. pjesëve të posaçme në ndërkohë të transportimit.
- Para aderimit të aparatit në rrjetën elektrike, aparatit le të qëndrojë në pozicion vertikal për afërsisht 2 orë. Kështu zvogëloni mundësinë e funksionimit jo të rregullt për shkak të ndikimit të transportit në sistemin e ftohjes.
- Kycja në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të realizohen në bazë të standardeve dhe rregullave në fuqi.
- Nuk lejohet përdorimi i aparatit në natyrë dhe se nuk lejohet të jetë nën ndikimin e të rreshurave.
- Para pastrimit dhe këmbimit të llambës, patjetër shkyçni aparatit nga rrjeta elektrike (nxjerrni kablonë kyçëse nga priza).
- Nëqoftëse kabloja kyçëse është e dëmtuar, le të këmbejë ate serviseri ose personi i aftësuar nga profesioni.
- Nëqoftëse aparatit nuk do të përdorni gjat kohë, ate e shkyçni me pullë dhe ndërpreni furnizimin me energji elektrike. Zbrazni aparatit, shkrini, pastroni dhe lejeni derën gjysëm të hapur.
- Për shkak të kujdesit ndaj rrethit, aparatit e harxhuar dorëzoheni tubuesve të autorizuar të aparateve të harxhuara.
- Për ambalazhim përdorim materiale të pranueshme për rrethin, të cilët, pa rrezik për rrethin mund të përpunohen përsëri, deponohen ose të zhduken.
- Le të mos lozin fëmija me aparatit.
- Etiketa me të dhënat elementare të aparatit gjendet në brendësi të aparatit. Nëqoftëse ajo është në gjuhën që juve nuk ju pëlqen, këmbejeni me ate të bashkangjiturën.
- **KUJDES!** Hapësirat (vrimat) për ajrosje në aparat, resp. në elementin instalues nevojitet të jenë gjithmonë të pastërta dhe të zbrazta.
- **KUJDES!** Mos përdorni tek shkrirja gjësende mekanike ose metoda tjera, përveç atyre që i rekomandon prodhuesi.
- **KUJDES!** Tek vendosja, pastrimi dhe evitimi i aparatit jeni të kujdesshëm që të mos dëmtoni izolimin resp. pjesët e sistemit për ftohje. Me këte parandaloni edhe ndotjen e ambientit.

- **KUJDES!** Mos përdorni mbaresat elektrike në brendësi të aparatit, përveç atyre të cilat i lejon prodhuesi i aparatit për ftohje dhe ngrirje.


Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2002/96/EG (waste electrical and electronic equipment - WEEE).

Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Këshilla për kursimin e energjisë elektrike te aparatet për ftohje dhe ngrirje

- Aparatin e poziciononi siç është përshkruar në udhëzime.
- Mos hapni derën e aparatit më shpesh se sa është e nevojshme.
- Kohë pas kohe kontrolloni që qarkullimi i ajrit pas aparatit të jetë i papengueshëm.
- Kondensatori në murinë e pasme të aparatit gjithmonë nevojitet të jetë i pastër (shiqo kapitullin Pastrimi i aparatit).
- Guarnicionin e dëmtuar ose joputhitës sa më parë ndërrojeni.
- Artikujt ushqimorë rruani në enët e mbyllura ose të ambalazhuara.
- Para se të konservohen, artikujt ushqimorë të ftohen në temperaturën e dhomës.
- Artikujt ushqimorë të ngrirë nevojitet të shkrihen në hapësirën e ftohjes.
- Evitoni sirtarët dhe derëzat në ngrirës siç është përshkruar në udhëzime, që të shfrytëzoni tërë vëllimin.
- Ngrirësin klasik e shkrihi pasi që në sipërfaqet e ftohura tubohet përafërsisht 3-5 mm ngricë, resp. akull.

Përshkrimi i aparatit



A Ndarja e ngrirësit

- 1 Raft

B Ndarja e freskuesit

- 2 Njësia e kontrollit
- 3 Raft (lartësia e rregullueshme)
- 4 Ulluku/kanali i shkarkimit të ujit
- 5 Ena/sirtari i frutave dhe perimeve
- 6 Rafti i derës së freskuesit (variant i thellë dhe i cekët)
- 7 Këmbë e rregullueshme


Vendosja dhe aderimi

Zgjedhja e ambientit

- Aparatin e vendoni në hapësirë të thatë dhe të ajrosur. Me rregullsi funksionon tek temperaturat e rrethit, e këta janë të parashtruara në tabelë. Klasa është e cekur në etiketën me të dhënat elementare për aparatin.

Klasa	Temperatura
SN (subnormale)	prej +10°C deri në +32°C
N (normale)	prej +16°C deri në +32°C
ST (subtropike)	prej +16°C deri në +38°C
T (tropike)	prej +16°C deri në +43°C

Vendosja e aparatit



Tek vendosja e aparatit le të bashkëpunojnë së paku dy persona, që të parandalohen dëmtimet e aparatit ose lëndimet e njerëzve.

- Aparati le të qëndrojë rrafsh dhe stabil në dysHEME mjaft të fortë. Në anën frontale të aparatit gjenden këmbëzat rregulluese, me të cilat barazpeshoni aparatin. Në anën e mbrapme gjenden rrotëzat të cilat mundësojnë vendosjen më të lehtë të aparatit (e përbajnë vetëm disa modele të aparatit).
- Elementi mbi aparat nevojitet të jetë i venduar mbi aparat së paku 5 cm, kjo mundëson ftohje të mjaftueshme të kondensatorit.
- Mos vendoni aparatin nën ndikimin direkt të rrezeve të diellit dhe se mos e vendoni në afërsi të burimeve të ngrohjes. Nëqoftëse kësaj nuk mund t'i largoheni, instaloni pllakë izoluese.

Kyçja e aparatit

- Aparatin e kyçni në rjetën elektrike me kablo kyçëse. Priza në muri nevojitet të jetë e pajisur me kontakt tokëzues (priza mbrojtëse). Tensioni i paraparë elementar dhe frekuenca janë të cekura në etiketën me të dhënat elementare të aparatit.
- Kyçja në rjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të jetë i realizuar sipas standardeve dhe rregullave në fuqi. Aparati reziston oscilime afatshkurte të tensionit elementar, por më së shumti prej -6% deri në +6%.

Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës

Mjetet e nevojshme: Kaçavidë e llojit Filipis / Kaçavidë e rrafshët / Çelës eksagonal.



- 1) Hiqeni mbulesën e menteshës së djathtë sipër (A).
- 2) Hiqini vidhat (B) e fiksuara në menteshën e sipërme me kaçavidën kryq.
- 3) Kalojini në anën tjetër menteshën e sipërme, bllokuesin e sipërm kufizues të derës dhe pjesën me kunjjin mbajtës / rrotullues.
 - a) Hiqeni dadon me këmishë. hiqeni rondelen, pastaj hiqini akset në anën tjetër dhe shtrëngojini.
 - b) Hiqeni bllokuesin kufizues të derës.
 - c) Ju lutemi të merrni një bllokues tjetër të derës, me vidha të montueshme në derë.
- 4) Çmontojini vidhat e fiksuara në menteshën e poshtme (C) me kaçavidën kryq.
Shënim: këndi i animit të freskuesit-ngrirësit të jetë më pak se 45° .
- 5) Ndërojeni pjesën me kunjjin mbajtës / rrotullues dhe bllokuesin e kufizimit të poshtëm.
- 6) Kalojeni menteshën e poshtme në anën tjetër pastaj shtrëngojeni atë me vidhat.
- 7) Ndërojeni menteshën e mesit.
- 8) Vendoseni pozicionin e duhur të derës së poshtme, shtrëngojeni menteshën e mesit.
- 9) Ndërojeni menteshën e sipërme.
- 10) Vendoseni pozicionin e duhur të derës së sipërme, shtrëngojeni menteshën e sipërme dhe mbulesën.
- 11) Vendosini katër kapakët e vidhave dhe dy kapëset në pozicionin përkatës.

Sigurojuni që Pajisja Elektroshtëpiake nuk është vënë në prizë dhe është bosh.


Rregullojini dy këmbët niveluese në pozicionin e tyre më të lartë.

Ne rekomandojmë që të keni dikë për t'ju ndihmuar.



1.




2.




3.



c.



4.




5.



7.



6.




10.




8.



9.




Komandimi i aparatit



A Pulla për rregullimin e temperaturës dhe kyçje/shkyçje të aparatit



Kyçja/shkyçja e aparatit



Kyçja: pullën **A** rrotulloni në drejtim të akrepit të orës.

Shkyçja: pullën **A** rrotulloni prapas ashtu që pozicioni i shigjetës të qëndrojë te shenja ● (kujdes: aparati është akoma nën tension elektrik).

Përzgjedhja e temperaturës në aparat



- Temperaturën e dëshiruar e rregulloni me pullën **A** edhe ate ashtu që pullën e rrotulloni në drejtim të akrepit të orës, domethënë djathtas.
- Ndryshimi i temperaturës së rrethit ndikon në temperaturën në aparat. Kësaj nevojitet t'i përshtatet rregullimi i pullës **A**. Pozicionet kah **pjesa më e trashë e signacionit** kanë domethënie të temperaturës më të ulët në aparat (më ftohtë), kurse pozicionet **kah pjesa më e hollë e signacionit** temperaturë më të lartë (më ngrohtë).
- Nëqoftëse temperatura e ambientit në të cilin është i vënduar aparati është më e ulët se 16°C, preferojmë rregullimin e pullës **A** në **pjesën më të trashë të signacionit**.

Rradhitja e rekomanduar e artikujve ushqimor në aparat

Rradhitja e rekomanduar e artikujve ushqimor në aparat

Pjesët e frigoriferit:

- **pjesa e sipërme:** ushqimi i konservuar, buka, verat, ëmbëlsirat...
- **pjesa e mesit:** prodhimet e qumështit, artikujt ushqimorë të pregaditur, ëmbëlsirat, lëngjet, birra, artikujt ushqimorë të zierë...
- **pjesa e poshtme:** mishi, prodhimet e mishit, delikatesa...
- **ena për perime:** pemët e freskëta, perimet, sallatat, perimet me rrënjë, patatet, qepët, hudhrat, domatet, pemët tropikale, lakrat turshi, repat...

Pjesët e derës së frigoriferit:

- **pjesa e epërme/e mesme e derës së frigoriferit:** vezë, tëly, djathra...
- **pjesa e poshtme e derës:** pije, konserva, shishe...

Pjesët e frigoriferit:

- ngrirja, ruajtja e artikujve ushqimorë të ngrirë (shiqoni kapitullin Ngrirja dhe ruajtja e artikujve ushqimorë të ngrirë).

Ruajtja e artikujve ushqimor në frigorifer

Vërejtje të rëndësishme për ruajtjen e artikujve ushqimor të ngrirë

- ⚠ Përdorimi i drejtë i aparatit, ambalazhimi përkatës i artikujve ushqimor, mirëmbajtja e temperaturës adekuate dhe marja në përfillje e higjienës së artikujve ushqimor, esencialisht ndikon në cilësinë e ruajtjes së artikujve ushqimor.
- ⚠ Respektoni afatet e përdorimit të artikujve ushqimor, të cilët janë të shënuar në ambalazhin e prodhimit.
- ⚠ Artikujt ushqimor, të cilët i ruani në frigorifer, duhet të jenë të mbyllur në enë ose në ambalazhin përkatës, që të mos lëshojnë apo pranojnë aromë dhe lagështi.
- ⚠ Mos ruani në frigorifer lëndë avulluese, djegëse dhe shpërthyes.
- ⚠ Shisheet me përmbajtje të lartë alkoolike duhet të jenë mirë të mbyllura dhe në pozicion vertikal (qirithi).
- ⚠ Disa tretësira organike, vajrat eterike në livoret e limonës dhe portokallit, acidet në tëlym dhe të ngjashme, tek kontaktet afatgjate me sipërfaqet plastike ose me guarnicionin mund të shkaktojnë dëmtime dhe vjetërsim të parakohshëm.
- ⚠ Aroma e pakëndshme na paralajmëron për papastërtinë e aparatit, respektivisht për përbërjen e prishur (shiqoni Pastrimi i aparatit).
- ⚠ Nëse shkoni nga shtëpia për një kohë më të gjatë, largoni nga frigoriferi artikujt ushqimor që prishen shpejt.

Pajimet e brendshme të frigoriferit



Pajimet varen nga modeli.

- Raftin mund ta rradhitni sipash dëshirës në brendësi të frigoriferit. Është e siguruar kundër nxjerrjes. Nëse dëshironi ta nxjerrni nga frigoriferi, në pjesën e parme çojeni pak lartas, sipas nevojës mënjanojeni dhe tërhiqeni. Artikujt ushqimor që prishen shpejt ruajini në pjesën e pasme të raftit, ku është shumë ftohtë.
- Ena pjesën e poshtme të frigoriferit nën raftin prej xhami është e dedikuar për ruajtjen e pemëve dhe perimeve. Garanton lagështi dhe terje më të vogël të artikujve ushqimor. Artikujt ushqimorë nevojitet të jenë të ambalazhuara në mënyrë të përshtatshme që të mos lëshojnë ose pranojnë duhma ose lagështi.
- Ana e brendshme e derës së frigoriferit është e pajisur me hapësira (raftet ose enëzat, të cilat janë të dedikuara për ruajtjen e djathit, tëlynit, vezëve, jogurtit dhe paketimeve tjera më të vogla, tubave, konservave dhe të ngjashme. Në pjesën e poshtme të derës është hapësira për shishe.

Koha e ruajtjes së artikujve ushqimor

Koha e preferuar e ruajtjes në frigorifer

Artikulli ushqimor	Koha
vezët, marinada, mishi i tymosur	deri 10 ditë
djathi	deri 10 ditë
rrënjëzat	deri 8 ditë
tëlyni	deri 7 ditë
ëmbëlsirat, pemët, ushqimet e gatshme, mishi i freskët në copë	deri 2 ditë
peshqit, mishi i freskët dhe i prerë, frutat e detit	deri 1 ditë

Ngrirja dhe ruajtja e artikujve ushqimor të freskët

Procesi i ngrirjes








Sasia maksimale e artikujve ushqimor të freskët, të cilat përnjëherë lirisht mund ti futni në frigorifer, është e shënuar në etiketën me të dhënat elementare të aparatit. Nëse sasia është më e madhe, cilësia e ngrirjes është më e dobët, gjithashtu e zvogëlon edhe cilësinë e ngrirjes së artikujve ushqimor tanimë të ngrirë.

- 24 orë para ngrirjes së artikujve të freskët ushqimorë rrotullojeni pullën **A** kah pjesa më e trashë e signacionit.

Artikujt ushqimorë të freskët të mos fërkohen me qeskat e ngrira!

- Për ngrirjen e sasive të vogla të artikujve ushqimorë të freskët (1-2 kg), rregullimi i ngrirjes intensive nuk është i nevojshëm.
- Pas përfundimit të ngrirjes, rrotullojeni pullën **A** përsëri në rregullimin e dëshiruar.

Vërejtje të rëndësishme për ngrirjen e artikujve ushqimor të freskët

-  Në frigorifer ngrini vetëm artikuj ushqimor, të cilët janë të përshtatshëm për ate. Gjithmonë le të jenë cilësore dhe të freskëta.
-  Zjidhni ambalazhin përkatës artikullit ushqimor dhe ambalazhojeni me rregullsi.
-  Ambalazha të mos lëshojë lagështi dhe ajër, që artikujt ushqimor të mos thahen dhe të mos humbin vitamina.
-  Artikujt ushqimor të ambalazhuar shënoni me të dhënat për llojin, sasinë dhe datën e ngrirjes.
-  Është e rëndësishme, që artikujt ushqimor të ngrijnë sa më shpejt, prandaj mbështjellëset le të jenë të vogla. Para ngrirjes, artikujt ushqimor ftohni.

Ruajtja e artikujve ushqimor të ngrirë industrialisht

- Gjatë ruajtjes dhe përdorimi të artikujve ushqimor të ngrirë, respektoni udhëzimet e prodhuesit. Në ambalazh janë të shënuara temperatura dhe afati i ruajtjes.
- Zgjidhni artikuj ushqimor me ambalazh të padëmtuar, të ruajtura nëpër frigoriferë në temperaturë -18°C ose më të ulët.
- Mos bleni artikuj ushqimor me ngricë, sepse, ata kanë qenë shumëherë të shkrira dhe të ngrira përsëri dhe cilësia e tyre është e dobët.
- Gjatë transportit siguroni artikujt ushqimor nga shkrirja. Ngritja e temperaturës e shkurton kohën e ruajtjes dhe e zvogëlon cilësinë e tyre.

Koha e ruajtjes së artikujve ushqimor të ngrirë

Koha e preferuar e ruajtjes në frigorifer

Artikulli ushqimor	Koha
pemë, mish lope	prej 10 deri 12 muaj
perime, mish viçi, shpendia	prej 8 deri 10 muaj
egërsira	prej 6 deri 8 muaj
mish derri	prej 4 deri 6 muaj
mish i prerë	4 muaj
buka, ëmbëlsira, ushqimet e gatshme, peshku	3 muaj
imtësisrat	2 muaj
suxhuk i tymosur, peshk i yndyrshëm	1 muaj

Shkrirja e artikujve ushqimor të ngrirë

Me ngrirjen e artikujve ushqimor mikroorganizmat nuk zhduken. Pas shkrirjes, ata në mënyrë të përshtetshme aktivizohen dhe shpejtë e prishin artikullin ushqimor. Prandaj, artikujt ushqimor përsëri të shkrirë përdorni sa më parë. Shkrirja e pjesëshme e ul vlerën ushqyese të artikullit ushqimor, veçanërisht pemët dhe perimet dhe ushqimet e pregaditura paraprakisht.

Shkrirja automatike e frigoriferit

Frigoriferin nuk duhet ta shkrihi, sepse akulli në murin e pasme të brendësisë së frigoriferit shkrihet automatikisht.

Akulli i mbetur në kohën e mosfunksionimit të kompresorit shkrihet. Pikat pikojnë nëpërmjet ollukut në murin e pasme të frigoriferit, në enëzën mbi kompresor, ku avullohen.

Në rast, se në murin e pasme të brendësisë së frigoriferit mbliidhet shtresë e tepërt e akullit (3-5 mm), aparatit shkyçeni dhe akullin shkrijeni me dorë.

Shkrirja e ngrirësit

- Frigoriferin shkrijeni, kur të mbliidhet afërsisht 3-5 mm ngricë respektivisht akull.
- 24 orë para shkrirjes, rrotullojeni pullën **A** kah pjesa më e trashë e signacionit;.

Pas kësaj kohe nxirni artikujt ushqimor të ngrirë nga frigoriferi dhe siguroni ata që të mos shkrihen.

- Shkyçni aparatit – rrotullojeni pullën e termostatit **A** në pozicionin ● dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.
- Leni derën të hapur aq kohë, saqë acarin respektivisht akullin mund lehtë të evitoni nga sipërfaqja. Këtu mund të ndihmoheni me kërruese nga plastika, por jeni të kujdesshëm që të mos dëmtoni sipërfaqet e brendëshme të ngrirësit. Acarin, respektivisht akullin para se të shkrihet fshijeni me leckë nga ngrirësi.
- Aparati nuk shkrihet me pajime elektrike (terësi për flokë dhe të ngjashme).
- Gjatë shkrirjes mos përdorni sprucues për shkrirje, sepse mund ti shkrijnë pjesët plastike respektivisht e dëmtojnë shëndetin.
- Brendësinë e aparatit pastrojeni dhe terjeni (shiqo Pastrimi i aparatit).
- Para se ti futni artikujt ushqimor në frigorifer, kyçni aparatit dhe rrotullojeni pullën **A** prapë në rregullimin e dëshiruar.

Para pastrimit shkyçeni aparatin nga rrjeti elektrik -

rrotullojeni pullën e termostatit **A** në pozicionin ● dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.

- Për pastrimin e të gjitha sipërfaqeve përdorni **lehtë të thatë**. Lëndët pastruese, që përmbajnë **lëndë abrazive, acide ose tretësira, nuk janë të përshtatshme**, sepse e dëmtojnë sipërfaqen!

Pjesën e jashtme të aparatit pastrojeni me ujë respektivisht me tretësirë të holluar të detergjentit.

Sipërfaqet e lustruara dhe ata nga alumini mund ti pastroni me ujë të vokët, të cilin i keni shtuar lëndë pastruese të holluar. Lejohet përdorimi i lëndëve pastruese me përmbajtje të ulët të alkoolit (psh. Lëndë për pastrimin e xhamit).

Për materialet plastike përdorimi i lëndëve pastruese, të cilat përmbajnë alkool, nuk është e lejuar.

Pjesën e brendëshme të aparatit pastrojeni me ujë të vokët, të cilin mund ti shtoni pak uthull.

- Nën pllakën ftohëse, e cila e ftof brendësinë e frigoriferit, janë olluku dhe hapësira, ku rrjedh uji i shkrirë. Olluku dhe hapësira nu guxojnë të jenë të shtupuara, prandaj shumëherë shiqoni dhe sipas nevojës pastroni (psh. me karthi plastike).
- Ngricat respektivisht shtresat e akullit, me trashësi 3-5 mm, e risin harxhimin e energjisë elektrike, prandaj ato rregullisht evitoni. Mos përdorni sende të mprehta, tretës dhe sprucues.
- Pas pastrimit, kyçni aparatin dhe futni artikujt ushqimor.



Evitimi i pengesave

Problemi:	Shkaku ose zgjidhja:
Frigoriferi juaj nuk funksionon:	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është vendosur kablli i furnizimit me energji. • Çelësi i termostatit është vendosur në pozicionin OFF.
Nuk punon drita:	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është vendosur kablli i furnizimit me energji. • Ka rënë siguresa e shtëpisë ose stakuesi i qarkut. • Poçi i llampës në portollampë është i lirë. • Është djegur poçi i llampës.
Ushqimi në ndarjen freskuese ka ngrirë:	<ul style="list-style-type: none"> • Çelësi i termostatit është caktuar shumë ftohtë. • Vendi i mbajtjes së ushqimit takon në pjesën funksionale, në murin e pasëm të frigoriferit.
Ushqimi në ndarjen freskuese nuk është ftohur:	<ul style="list-style-type: none"> • Ventilatorët e ajrit në ndarje janë bllokuar. Kjo ndalon qarkullimin e ajrit të ftohtë. • Dyert janë hapur shumë shpesh ose nuk janë mbyllur siç duhet. • Në ndarjen freskuese ose në frigorifer sapo është shtuar një sasi e madhe ushqimi. • Pozicioni i çelësit të termostatit është caktuar shumë pak.
Akulli i shkrirë ka rrjedhur mbi ndarjen brenda ose në dysheme:	<ul style="list-style-type: none"> • Është bllokuar hyrja e grykës së shkarkimit. • Ena e avullimit është në vend.
Duket sikur frigoriferi bën zhurmë jo të zakonshme:	<ul style="list-style-type: none"> • Frigoriferi është i niveluar në dysheme. • Trupi i frigoriferit prek murin. • Nuk është vendosur siç duhet tava e kullimit.
Është krijuar lagështirë e brendshme:	<ul style="list-style-type: none"> • Ventilatorët e ajrit në frigorifer janë bllokuar. • Dera është hapur shpesh. • Dhoma ka lagështirë. • Ushqimi nuk është ambalazhuar siç duhet. • Kontrolli nuk është vendosur saktësisht për kushtet e ambientit.
Dyert nuk mbyllen plotësisht:	<ul style="list-style-type: none"> • Raftet kanë dalë nga pozicioni. • Guarnicionet janë të papastra. • Frigoriferi nuk është në nivel.

Në qoftë se edhe metodat e mësipërme nuk janë të efektshme, ju lutemi të kontaktoni pa vonesë me departamentin e shërbimit të mirëmbajtjes për t'ju ndihmuar.

Ftohjen në aparatet ftohës-ngjirës e mundëson sistemi ftohës me kompresor (tek disa aparate edhe ventilator), ajo pra shkakton zhurmë të caktuar. Fuqia e zhurmës varet nga rregullimi, përdorimi i drejtë dhe vjetërsia e aparatit.

- **Pas nisjes** së aparatit, mundësohet funksionimi i kompresorit (zhuburitje e lëngjeve) respektivisht qarkullimi i lëndës ftohëse gjatë funksionimit është më i zëshëm. Ajo nuk është shenjë prishjeje dhe nuk ka ndikim në kohën e jetës së aparatit. Me kohë gjatë funksionimit të aparatit zërimi i atyre zhuburitjesh zvogëlohet.
- Disa herë, gjatë funksionimit të aparatit paraqiten edhe **zhuburitje të pazakonshme ose më të fuqishme**, të cilat për aparatit janë të pazakonshme dhe në të shumtën e rasteve janë si pasojë e rregullimit joadekuat:
 - Aparati duhet të qëndrojë drejtë dhe stabil në dysheme të fortë.
 - Nuk guxon të preken muritë ose elementet fqinje.
 - Kontrolloni, se a janë pajimet e brendshme në vendin e vetë, respektivisht se a bëjnë rapëllimë konservat, shishet ose enët tjera, sepse ndërmjet veti fërkohen.

MARIM TË DREJTË PËR NDRYSHIMET TË CILAT NUK
NDIKOJNË NË FUNKSIONIMIN E APARATIT.



Gorenje, d.d.
Partizanska 12
SI - 3503 Velenje, Slovenija
info@gorenje.com
www.gorenje.com